

VENDIM

Nr. 8, datë 11.1.2016

PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES DHE INDIVIDIT QË MERR PJESË NË OPERACIONE TË FSHEHTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 4, e 55, pika 2, të ligjit nr. 65/2014, "Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të cilit, për shkak të ushtrimit të detyrës, i kërcënohen jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë. Punonjësit të kësaj agjencie i garantohet mbrojtje e veçantë edhe kur merr pjesë në operacione të fshehta të agjencisë dhe përdor identitet të dyfishtë dhe kur, për shkak të detyrës ose bashkëpunimit, i rrezikohen jeta, shëndeti, familja apo prona.
2. Mbrojtje e veçantë i garantohet edhe individit që merr pjesë në operacione të fshehta të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe përdor identitet të dyfishtë dhe kur, për shkak të bashkëpunimit, i rrezikohen jeta, shëndeti, familja apo prona.
3. Me mbrojtje të veçantë, sipas këtij vendimi, nënkuptohen masat që merren për sigurimin e jetës, shëndetit, familjes apo pronës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes apo individit që merr pjesë në operacione të fshehta të kësaj agjencie dhe përdor identitet të dyfishtë.
4. Kriteret për të përfituar mbrojtje të veçantë janë, si më poshtë vijon:
 - a) Prania e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, shëndetin, familjen apo pronën e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
 - b) Prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, shëndetin, familjen apo pronën e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes apo individit që merr pjesë në operacione të fshehta të kësaj agjencie dhe përdor identitet të dyfishtë;
 - c) Prania e lidhjes shkakësore, ndërmjet rretha-nave serioze që rrezikojnë jetën, shëndetin, familjen apo pronën dhe ushtrimit të detyrës nga punonjësi ose bashkëpunimit nga individ.
5. Masat për mbrojtjen e veçantë janë, si më poshtë vijon:
 - a) ruajtja fizike;
 - b) ruajtja e banesës ose e pronës;
 - c) transferimi;
 - ç) dërgimi jashtë shtetit;

d) masa të tjera, në varësi të çështjes.

6. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes merr në shqyrtim rastet e paraqitura për mbrojtje të veçantë, me kërkesën e punonjësit, strukturës së interesuar të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose individit që merr pjesë në operacione të fshehta dhe përdor identitet të dyfishtë dhe, brenda 3 (tri) ditëve, i propozon ministrit të Mbrojtjes miratimin e urdhrit për mbrojtjen e veçantë.

7. Propozimi i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që i dërgohet për miratim ministrit të Mbrojtjes, përmban:

a) mbështetjen ligjore përkatëse;

b) gjeneralitetet e punonjësit apo individit;

c) të dhëna për rrethanat dhe domosdoshmërinë e marrjes së masave për mbrojtjen e veçantë;

ç) të dhëna për mënyrën e mbrojtjes, kohën kur do të merret në mbrojtje dhe afatin, strukturat që do ta zbatojnë dhe do ta kontrollojnë zbatimin, si dhe shpenzimet e nevojshme.

8. Në rastet e veçanta kur rrethanat përcaktojnë marrjen e masave të menjëhershme, ministri i Mbrojtjes, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes miraton urdhrin menjëherë.

9. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me kërkesë të punonjësit, strukturës së interesuar të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose individit, mund t'i propozojë ministrit të Mbrojtjes zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat për të cilat është siguruar më parë mbrojtja vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati.

10. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për zbatimin e masave të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, i drejtohet dhe mbështetet nga Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura dhe, në pamundësi të kësaj, nga Policia e Shtetit.

11. Shpenzimet për mbrojtjen e veçantë përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, akorduar për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

12. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama